



Datë: 29.10.2025
Numër Protokolli: 7087/2025

A .nr.1580/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1580/2025, të datës 11.08.2025, të parashtruar nga ankuesja M.J-N të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Muharrem Kurtaj nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Adminsitrativ i nisuar sipas numër A.nr.1580/2025, e datës 11.08.2025, e parashtruar nga ankuesja M.J.N.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil M.J.N(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 09.08.2025, përmes emailit ankesa.kpmsheck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 11.08.2025 nën shenjë A.nr.1580/2025, kundër njoftimit të datës 11.07.2025 për përzgjedhje përfundimtare të kandidatës për sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017332, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Ferizaj, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1580/2025, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017332, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Ferizaj numri i kërkuar gjashtë (6), klasa profesional 1, me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Tutje sipas provave të lëndës, rezulton se ankuesja, ndërsa pas përfundimit të procesit, rezulton se lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00017332, më datë 11..07.2025 Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, ka publikuar rezultatet përfundimtare kur rezultojnë 19 kandidatë që kanë marr mbi 70 pikë, ndërsa ankuesja nuk ka qenë pjesë e listës përfundimtare.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se janë tejkaluar afatet për mbajtjen e testit me shkrim, Vendimi i komisionit të pranimit është nxjerr nga personi jo kompetent. Kërkon që të aprovuar ankesë dhe të rishikuar testi, apo si alternative të anulohet njoftimin i kandidatëve të përzgjedhur.

Duke qenë së kandidati L.J, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit konkursit me Nr. Reference: RN00017332, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Ferizaj, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kontestuar procedurën e njëjtë, ndërsa, ky i fundit më Vendimin me numër A.nr.1372/2025, të datës 27.10.2025, kishte anuluar në tërësi procedurën e pranimit më Nr. Ref: RN00017332.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1580/2025, të datës 11.08.2025, ka të bëjë me procedurat e pranimit për të cilën Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1372/2025, të datës 27.10.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi këto procedura, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”, Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.1580/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1580/2025, të datës 11.08.2025.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1580/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Muharrem Kurtaj;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;